

URDHËR
Nr. 681, datë 21.12.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 616, DATË 9.11.2020, “PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES BRENDA VENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 7, pika 4, germa “d”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri nr. 5005/8, datë 21.12.2020, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 616, datë 9.11.2020, “Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Pika 1 e urdhrit riformulohet, si vijon:

“Kufizimin e lëvizjes së popullatës nga ora 20:30 deri në orën 06:00, duke filluar nga data 24.12.2020 deri në datën 4.1.2021.”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe fillon efektet më datë 24.12.2020. Pas datës 4.1.2021, kufizimi i lëvizjes së popullatës do të jetë në fashën orare nga ora 22:00 deri në orën 06:00 deri në një urdhër të dytë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu